

Shtojca 12.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr. _____ prot.

Lushnjë, më ____/____/ 2025

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

Datë : 03.12.2025

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “MODESTE” shpk, me Nipt : J62903413B

Adresa: Fier , L. 1 MAJ 15

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës : **“Sistemimi i sheshit dhe tregut të fruta-perimeve në lagjen “Skënder Libohova”, Rruga Pavarësia”, me fond limit: 15 310 675.13 (pesëmbëdhjetë milion e treqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë presje trembëdhjetë)Lekë pa TVSH, REF-66960-10-28-2025 dhe kohëzgjatje 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **29.10.2025**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike : **nr. 66 , data 03.11.2025**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **“Shendelli” shpk**

K07924803N

Vlera e ofruar : 11 075 074.5 (njëmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë e katër presje pesë) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Operatori ekonomik **“MODESTE” shpk**

J62903413B

Vlera e ofruar : 11 826 203 (njëmbëdhjetë milion e tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e tre) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ISOBAR CONSTRUCTION” shpk dhe “T&J Construction” shpk

L12210036D

M29718101T

Vlera e ofruar : 12 068 166,60 (dymbëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë) **lekë pa tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” shpk

K71820009I

Vlera e ofruar : 13 319 289.38 (trembëdhjetë milion e treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë presje tridhjetë e tetë) **lekë pa tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. Operatori ekonomik “SARK” shpk

K52531415H

Vlera e ofruar : 13 773 398 (trembëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) **lekë pa tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ISOBAR CONSTRUCTION” shpk dhe “T&J Construction” shpk
L12210036D M29718101T

BOE “ISOBAR CONSTRUCTION” shpk & “T&J Construction” shpk nuk ka paraqitur Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit. Mos plotësimi i këtij kriteri bie në kundërshtim me dispozitat e nenit 88, të V.K.M. Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar .

BOE “ISOBAR CONSTRUCTION” shpk & “T&J Construction” nuk ka paraqitur në SPE listën e çmimeve sipas zërave të preventivit. Përsa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, date 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta refuzohet.

2. Operatori ekonomik “Shendelli” shpk
K07924803N

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin provues të vetëdeklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe të dokumenteve të tjera shoqërues të ofertës, bazuar në nenin 82, të LPP-së dhe nenin 26, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konstatoi mangësi dhe parregullsi, si më poshtë:

Në formularin e vetëdeklarimit ngarkuar në SPE, si edhe pjesë e dokumentacionit provues dorëzuar pranë AK, për plotësimin e pikës 2.7 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme.... 1(një) Eskavator me zinxhir min 0.25 m³”. Operatori ekonomik ka vetëdeklaruar se e disponon mjetin Eskavator me zinxhir min 0.25 m³ në pronësi. Gjithashtu në të dhënat e tjera ka deklaruar se kjo vërtetohet me Faturën tatimore të blerjes me nr 528 dt 22.07.2024. Si dokumentacion provues për përmbushjen e këtij kriteri nga shqyrtimi i dokumentacionit provues të dorëzuar fizikisht pranë AK, nuk provohet disponueshmëria e mjetit Eskavator me zinxhir min 0.25 m³ pasi nuk është paraqitur asnjë dokument (kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese) për të provuar se ky mjet disponohet dhe është në pronësi të operatorit ekonomik “Shendelli” shpk, sikurse është deklaruar në Formularin e vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Në formularin e vetëdeklarimit ngarkuar në SPE, si edhe pjesë e dokumentacionit provues dorëzuar pranë AK, për plotësimin e pikës 2.7 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte

të Tenderit: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme.... 1(një) Rrul kompresor me vibrim”.Operatori ekonomik ka vetëdeklaruar se e disponon mjetin Rrul kompresor me vibrim në pronësi. Si dokumentacion provues për përmbushjen e këtij kriteri nga shqyrtimi i dokumentacionit provues të dorëzuar fizikisht pranë AK, nuk provohet disponueshmëria e mjetit Rrul kompresor me vibrim, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument (kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese) për të provuar se ky mjet disponohet dhe është në pronësi të operatorit ekonomik “Shendelli” shpk, sikurse është deklaruar në Formularin e vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Për sa më sipër, nuk provohet përmbushja e kriterëve për kualifikim. Mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 ,”Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta e operatorit ekonomik “**Shendelli**” shpk skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë : Operatorin ekonomik “**MODESTE**” shpk , me Adresë : Fier,L. 1 MAJ 15,se oferta e paraqitur me vlerë totale prej : **11 826 203** (njëmbëdhjetë milion e tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e tre) **lekë pa tvsh**,është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ERISELDA SEFA